ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-24-570-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me shoqeri bletesh**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" Bletaria Te Ahmeti " SH.P.K.**
NUI	**601696901**
Adresa	**"NEXHID HASANI"**
Vendi	**CECELI**
Kodi postar	**42000**
Numri Telefonit	**049891280**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Visar Krasniqi**
Adresa elektronike	**adnankrasniqi444@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**13.08.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me shoqeri bletesh

- **B05- Njoftimi për kontrate: 01.02.2024**
- **Sqarime ne pyetjet e derguara nga OE -Furnizim me shoqeri bletesh date :13.02.2024**
- **Afati për dorëzim te tenderit: 22.02.2024;**
- **Kriteret e dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët**
- **Procesverbal i hapjes se ofertave: 22.02.2024 ORA 14:00;**
- **B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues : 15.03.2024**
- **Njoftim per anulimin e Aktivietit : 21.06.2023**
- **Kerkesa per rishqyrtim date : 18.03.2024**
- **Pezullimi i aktivitetit date: 20.03.2024**
- **Vendim mbi Kerkesesn per rishqyrtim mbi refuzimin si te pa bazuar 22.03.2024**
- **Pezullimi i aktivitetit Ankes prane OSHP-se date : 29.03.2024**
- **Raporti i Ekspertit Shqyrtues date : 07.04.2024**
- **Vendimi panelit 2024/0276 date : 20.06.2024**
- **B58- Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues : 01.08.2024**
- **Kerkesa per rishqyrtim date : 05.08.2024**
- **Kthimi i pergjigjes per rishqyrtim refuzimi date : 07.08.2024**
- **Ankesa ne OSHP date : 14.08.2024**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Hapja ne mënyre elektronike e ofertave është bere me datën 22.02.2024- Nuk kemi marre pjese në hapje të ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne ne baze te kerkeses per rishqyrtim te dates 05.08.2024 konform dhe ne perputhje me nenin 108A te LPP-se jemi mundur te bejme zgjidhjen e mosmarreveshjeve duke i argumentuar me fakte AK-se mbi vleresimin jo te duhur ne kete aktivitet dhe diskriminimin e bere ndaj Kompanise sone por prap se prap AK-ja nuk ka reflektuar ne zgjidhjen e mosmarreveshjes dhe ne rastin tone na ka refuzuar kerkesen per rishqyrtim duke mos analizuar dhe lexuar si duhet faktet tona dhe ne rastin tone ne jemi te detyruar te bejme ankesen ne OSHP per te parandaluar keto diskriminime dhe mos vleresime , dhe duke i ipur kahje tjeter AK-ja vleresimit te kesaj lende.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Me datën 15.03.2024 përmes Platformës se E-prokurimit kemi pranuar formularin B58-Vendimin e AK ku ne jemi shpallur fitues per kete aktivitet ku kemi qene kompania e pergjegjshme dhe me cmimin me te ulet ashtu sipas kriterit te AK-se ne dosjen e tenderit , per shkak te kerkeses per rishqyrtim dhe ankeses ne OSHP me vendim te ekspertit shqyrtues lenda eshte rikthyer ne ri-vleresim prap ku me daten 01.08.2024 AK-ja merre vendim per te na eliminuar neve pa drejtesisht nga ky aktivitet duke mos permbushur pergjegjesit e tyre ligjore dhe sipas LPP-se te veprohet drejt dhe shpallin fitues nje operator i cili me pretendime te pa baza shpallet fitues . Ne duke aplikuar te drejten tone te bazuar me ligj te LPP-se bejme Kerkesen per rishqyrtim me date 05.08.2024

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 38 Sqarimi i Tenderëve pika 38.1 , 38.3 , 38.4 , 38.5 , 38.6

Më datën **01.08.2024** , Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL-GJILAN**në Platformën e E-prokurimit ka bere publikimin e Formularit - **B58 - Njoftim për Vendimin e Autoritetit Kontraktues.** Në këtë vendim AK na ka eliminuar neve si Operator Ekonomik me arsyetimin si me poshte :

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Komisioni për ekzaminimin, RI -vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ka konstatuar këtë procedurë të prokurimit si dhe bazuar ne Vendimin e OSHP-së 2024/0276 ku eshte konstatuar se nje kerkes e till ne forme e kerkes dhe deshmis nuk eshte kerkuar tek kriteret e perzgjedhjes mirpo vetem tek pytje sqaruese e dates 13.02.2024 ku , autoriteti kontraktues –se bashku me njesin kerkuses tek pytjes per sqarim e ka specifikuar llojin e bleteve qe duhet te ofertuar tek pytja nr 15. Raca e bletëve a duhet të jetë ApisMillfera apo race tjeter. Raca e kerkuar e bleteteve duhet te jete .:Apis mellifica var. carnica Pollm ku OE "Bletaria te Ahmeti sh.p.k " gjate ofertimi nuk ka sjell deklarat te nenshkruar dhe vulosur per oferimin e llojit të Bleteve sipas kerkeses se pytjes sqaruese (pytja nr .15) te dt 13.02.2024.

Rrjedhimisht, Komisioni Profesional për Egzaminimin dhe Vlerësimin e ofertave ka konstatuar se oferta juaj është e Papërgjegjshme.

Ketu vlene te ceket se arsyetimi nuk eshte i duhur dhe i vlefshmer per ne si OE , sepse ne kemi ofruar deklaraten per specifika teknike , vlene te ceket se AK-ja gjate gjithe fazes se vleresimit dhe marrjes se vendimeve ka bere shkelje ligjore substanciale te neneve ne fuqi te LPP-se keshtu duke bere nje vleresim jo profesional dhe jo sipas ligjit . AK-ja ka bere shkelje ligjore substanciale te neneve ne fuqi si me poshte :

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 38 Sqarimi i Tenderëve pika 38.1 , 38.3 , 38.4 , 38.5 , 38.6

ARGUMENTE :

Ne vendimin e dates 01.08.2024 AK-ja ka cekur arsyjen e eliminimit te ulet e cila sipas Ligjit nuk qendron sepse ne kemi pasur deklaraten origjinale te vulosur dhe nenshkruar nga kompania jone se qendrojme pas qdo specifike teknike konform Aneksit 1 te dosjes se tenderit . Por vlene te ceket se AK-ja nuk e ka lexuar dhe interpretuar si duhet edhe raportin e ekspertit shqyrtues te dates 07.04.2024 .

AK-ja ne vleresimin dhe vendimin e dates 01.08.2024 ka leshuar vendim pa baze pa e analizuar si duhet qeshtjen e lendes se ketije aktiviteti te shpallur nga vete kjo AK dhe nuk ka analizuar si duhet interpretimin e ekspertit shqyrtues . AK-ja nuk ka respektuar Nenin 1 , 6 ,7 , 52 , 60 , 69 dhe 72 **RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 38 Sqarimi i Tenderëve pika 38.1 , 38.3 , 38.4 , 38.5 , 38.6**

FAKTE:

Gabimi i pare : AK-ja ne Sqarime ne pyetjet e derguara nga OE -Furnizim me shoqeri bletesh te dates 13.02.2024

Shume kjarte citon ne pergjigjjet e veta tek pergjigjja e pare si me poshte ku po e vendosim per ta pare :

Nr.	**Pyetja nga OE**	**Pergjigjeja nga Autoriteti Kontraktues**
1	Përshkrimi i specifikave: 1. Shoqëritë e bletëve duhet të jenë të shëndosha (pa sëmundje), të forta (në gjeneratë dhe miza), të vendosura në shtëpiza të reja (të papërdorura) standarde të tipi LR (njëkatëshe). 2. Dyshemeja e re anti-varo ose klasike (e plotë) 3. Tavani i ri 4. Qatia e re 5. Të ketë 10 korniza standarde me hoje të mira 6. Shoqëritë e bletëve të kenë së paku 6 korniza me gjeneratë të stadeve të ndryshme 7. Shoqëritë e bletëve të kenë së paku nga 8 korniza të mbushura me miza (bletë) 8. Shoqëritë e bletëve të kenë mëmën jo më të vjetër se dy vjeqare 9. Të kenë së paku nga 6kg ushqim	Ky eshte Pershkrimi i Specifikimeve teknike ne Aneksin nr.1 I vendosur nga Autoriteti Kontraktues (AK) . - Se bashku me oferten duhet te dorezohet - **Deklarata e nenshkruar dhe e vulosur nga OE ne te cilin deklarohet se se i ka lexuar dhe kuptuar mire specifikat** që duhet ti plotësojnë shoqëritë e bletëve dhe të zotohet se do ti plotesoje te gjitha sipas kërkesave te Autoritetit Kontraktues. - Ndersa gjate fazes se menaxhimit te kontrates ,menaxhimi I kontrates do te behet sipas ketyre specifikatave te kerkuara ne Aneksin nr.1 nga AK-ja .Ne rast se kontraktori per furnizimet e dorezuar nuk I permbush keto kerkesa ,kontrata do te shkeput

Shikojeni pergjigjjen tuaj ku e keni cituar mjafte kjarte qe se bashku me oferten duhet te dorezohet Deklarata e nenshkruar dhe vulosur nga OE ne te cilen deklarohet se i ka lexuar dhe kuptuar mire specifikat – NE KETE GJE E KEMI BERE KU KEMI OFRUAR DEKLARATEN QE I PERMBUSHIM GJITHA SPECIFIKAT TEKNIKE KONFORM KERKESES SE AK-SE NE GJITHA SPECIFIKAT TEKNIKE SIPAS ANEKSIT 1 TE DOSJES SE TENDERIT.

Andaj AK-ja ne vendimin e dates 01.08.2024 ka gabuar ne vendimin per eliminim te kompanise sone ne vendim jo te drejt jo profesional dhe nje vendim skandaloz duke mos shikuar pergjigjjet e tyre te dhena me date 13.02.2024 kjo eshte vetem njera nga gabimet ne vendim te AK-se e cila nuk eshte dashur te ndodhte.

Gabimi i dyte i AK-se eshte se nuk ka lexuar dhe kuptuar si duhet interpretimin dhe pergjigjjen nga eksperti shqyrtues ku ka cituar si me poshte :

Rekomandojmë qe nje sqarim i tillë sipas nenit 72 te LPP-së dhe nenit 38 te Rregullores per Prokurim Publik , AK-KK GJILAN te i bëjë gjatë procedurës se rivlerësimit te ofertave dhe te sqarohet lloji i ofruar i bletëve sepse nuk mund te shpërblehet nje operator ekonomik me kontratë pa përcaktuar llojin e ofruar te furnizimeve.

Shikojeni me larte se qka ka kerkuar eksperti shqyrtues nga ju si AK , gje te cilen nuk e keni bere nuk e keni marre kete rekomandim te ekspertit ku ka kerkuar nga ju ne baze te nenit 72 dhe nenit 38 te rregullores qe gjate rivleresimit te ofertave te sqarohet lloji i ofruar i bleteve , kete gje ju nuk e keni bere sepse nuk keni derguar tek ne sqarim ne lidhje me kete , dhe per kete gje ju keni shkelur ligjin nenin 72 dhe 38 te rregullores dhe rekomandimin e ekspertit. Keni bere vendim te ngutshem aspak profesional aspak ne harmoni me LPP-ne , por vendim te pa bazuar krejt kjo ka rrjedhe nga nje jo profesionalizem i juaj duke mos aplikuar rekomandimin e ekspertit dhe duke mos analizuar dhe lexuar ne teresi raportin.

Gabimi i tret i AK-se eshte sipas Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Shume kjarte ne Ligjin e Prokurimit Publik citohet te ky nen si me poshte:

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

AK-ja ne rastin tone nuk ka perfillur kete nen duke mos na ftuar ne si OE per te plotesuar apo ne rastin tone te qartesojme llojin , kjo eshte shkelje nga AK-ja sepse nuk ka vepruar si duhet ne vleresim , ka bere vleresim te gabuar jo te drejte duke mos vleresuar sipas kushteve dhe neneve te LPP-se .

Gabimi i katert i AK-se eshte **RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK - Neni 38 Sqarimi i Tenderëve pika 38.1 , 38.3 , 38.4 , 38.5 , 38.6**

38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet

përmes platformës elektronike.

AK NUK E KA BERE KETE

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifkatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dështmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifkatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.

38.6 AK do të caktoj afat kohor të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre.

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër sipas LPP-se dhe neneve ne fuqi dhe rregullores ne fuqi vijme ne perfundim se AK-ja ka bere vleresim te gabuar te ketije aktiviteti duke mos perfilluar si duhet REKOMANDIMIN E EKSPERTIT dhe duke mos perfilluar Nenin 72 dhe neni 38 te rregullores ku mjafte kjarte i kemi shtjelluar me larte . Ky vendim i AK-se vjen ne nje vendim jo profesional te ngutur dhe tendencioz duke na eliminuar neve si kompani e cila kemi qene e pergjegjshme me cmimin me te ulet te ofruar ne krahasim me oe te tjere dhe fitues sipas vendimit te AK-se te dates 15.03.2024.

Nga kronologjia e bere ankeses sone i kemi prezantuar me fakte dhe detaje 4 gabimet qe

AK-ja ka bere ne vleresimin dhe krahasimin se si duhet te bere ketije aktiviteti .

AK-ja ka bere shkeljet ligjore sipas neneve te cilat i kemi cituar ne kete ankes

Dhe njehere Bazuar në të gjitha këto të dhëna të shënuara me larte dhe dëshmitë e bashkangjitura kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues i kesaj lende dhe nga paneli shqyrtues i OSHP-se, Ankesen tone dhe pretendimet tona ankimore të merre si të bazuar dhe të faktuar , ta anuloj Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 01.08.2024, dhe lenden te ktheje ne **RI-VLERESIM.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mohimi i të drejtës tonë për nënshkrim të kontratës dhe veprimet që keni marre ndaj kompanise sone na ka shkaktuar dëme të pa riparueshme në reputacionin dhe imazhin tone,

fitimet e pritura, shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të ofertës, shpenzimet e përgatitjes të Kërkeses për Rishqyrtim ku kemi angazhuar ekspert te fushes dhe shpenzimet e kostos se Ankeses ne OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*